L I G J
Nr.7824. datë 18.5.1994

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.7745, DATË 26.7.1993 "PËR RIVLERËSIMIN DHE SHPËRNDARJEN NË VLERË TË PASURISË SË ISH-KOOPERATIVAVE BUJQËSORE"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Në ligjin nr.7745, datë 2.7.1993 "Për rivlerësimin dhe shpërndarjen në vlerë të pasurisë së ish-kooperativave bujqësore", pas nenit 1 shtohet neni 1/a me këtë përmbajtje:

"Objektet socialkulturore, pasuri e ish-kooperativave bujqësore, që ekzistojnë fizikisht, të ndërtuara e përdorura për nevojat e arsimit,kulturës, sporteve, shëndetësisë, dhe zyrat e ish-këshillave popullore dhe ish-kooperativave bujqësore kalojnë kundrejt shpërblimit pasuri e komunës ose bashkisë, me vendim të këshillit përkatës, për t'u përdorur për nevoja publike nga vetë komuna ose bashkia si dhe për dhënien me qira të tyre për të njëjtin qëllim. Shpërblimi të bëhet brenda 3 vjetëve.

Objektet socialkulturore të sipërpërmendura, kur janë zënë në mënyrë të paligjshme nga subjekte të ndryshme, mbi bazën e vendimit të këshillit përkatës lirohen brenda 1 muaji. Për rastet kur objekti është adaptuar për banesë dhe shtetasi nuk ka banesë tjetër, ky afat zgjatet deri në 6 muaj. Kur në këto objekte janë sistemuar për banim ish-të përndjekurit politikë që kanë fituar statusin sipas ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", lirimi i tyre bëhet me plotësimin nga shteti të detyrimeve që rrjedhin nga statusi për këtë kategori shtetasish.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.853, datë 30.5.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha